

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur

Viti XXIV, nr. 7195

E shtunë, 25 maj 2024

Çmimi 0.50 €

Shtyhet debati në Kuvend për qeverinë Kurti

FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E KOMBEVE TË BASHKUARA KA MIRATUAR REZOLUTËN PËR GJENOCIDIN NË SREBRENICË

FAQE 4

DITA NDËRKOMBËTARE E PËRKUJTIMIT TË GJENOCIDIT NË SREBRENICË VENDOSSET NË KALENDARIN ZYRTAR TË OKB-së



Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara e ka miratuar një rezolutë për ta kujtuar çdo vit gjenocidin e kryer

më 1995 në Srebrenicë të Bosnjë-Hercegovinës. Rezoluta është miratuar me 84 vota për. Dita Ndërkombëtare e Përkujtimit të

Gjenocidit në Srebrenicë, 11 korriku, tashmë është shënuar në kalendarin zyrtar në faqen e OKB-së

KOSOVA NË UASHINGTON BLEN OBJEKT PËR AMBASADË

F.7



AVANCIMI I STATUSIT TË KOSOVËS NË AGJENDËN E ASAMBLESË PARLAMENTARE TË NATO-s

F.3

RENOVA

Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
PUTZ
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk



NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE

INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

AKTUALE



GJND-JA URDHËRON IZRAELIN QË "MENJËHERË TA NDALË" OFENSIVËN NË RAFAH

F.2

POLICIA NË SHQIPËRI I ARRESTON KATËR PERSONA PËR TRAFIKIM TË ARMËVE NGA KOSOVA

F.7

DJALI I AFRIM BUNJAKUT PUNËSOHET NË NDËRMARRJEN PUBLIKE TË VUSHTRISË

F.6

EKONOMI



IKD: SHTETI VAZHDON T'I PËRJASHTOJË PENSIONISTËT DUKE MOS I HARMONIZUAR PENSIONET ME KOSTON E JETESËS SIÇ UA GARANTON LIGJI

F.8

ODA AMERIKANE KËRKON NDËRPRERJEN E NDËRHYRJES SË SHTETIT NË TREGUN E KARBURANTEVE

F.8

SPORT



SOT ZHVILLOHET XHIROJA E FUNDIT NË SUPERLIGË

F.10



Kolegji
BIZNESI

www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË

Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net



INFINITY
Digital Agency

Endrit Shaqiri
+38344685122

Internet Website,
Marketing...

ShBA-ja po shqyrton marrëdhëniet me Gjeorgjinë për shkak të ligjit për “agjentët e huaj”

UASHINGTON, 24 MAJ - Shtetet e Bashkuara njoftuan se janë duke i shqyrtuar marrëdhëniet dypalëshe me Gjeorgjinë për shkak të ligjit kontrovers për “agjentët e huaj”, i cili nxiti protesta të mëdha në kryeqytetin Tbilisi.

Në një komunikatë për medie, sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, tha se Uashingtoni do të vendosë edhe regjim vizash ndaj individëve që janë përgjegjës për “minimin e demokracisë në Gjeorgji”.

Legjislacioni që formalisht quhet Ligji për Transparencë mbi Ndikimin e Huaj - shihet si kopje e një ligji shtypës që zbatohet në Rusi. Besohet se ky ligj ia rrezikon vendit rrugën drejt integritimit në Bashkim Evropian dhe e sjell Tbilisin më afër Moskës.

Ky ligj është dënuar nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian, i cili ka thënë se ai “nuk është në përputhje” me përpjekjet e kamotshme të Gjeorgjisë për t’iu bashkuara bllokut. “Departamenti i Shtetit po zbaton një politikë të re për

regjim vizash për Gjeorgjinë, i cili do të vlejë për individët të cilët janë përgjegjës për, apo bashkëfajtorë për minimin e demokracisë në Gjeorgji, si dhe për anëtarët e familjeve të tyre”, tha Blinken.

Në komunikatë nuk përmenden me emër individët të cilët do të sanksionohen.

Kritikët kanë thënë se ky legjislacion u soll nga partia në pushtet, Ëndrra Gjeorgjiane, me qëllim për ta ruajtur pushtetin nga kjo parti para zgjedhjeve të këtij viti, të cilat shihen si vendimtare për rrugën euroatlantike të Gjeorgjisë.

Uashingtoni ka qenë mbështetës i palëkundur i integritimit perëndimor të Gjeorgjisë, dhe Blinken tha se ai do ta bëjë një “shqyrtim gjithëpërfshirës të marrëdhënieve dypalëshe mes ShBA-së dhe Gjeorgjisë”.

“Mbështetja amerikane për demokracinë e Gjeorgjisë është afatgjatë dhe thelbësore për marrëdhëniet tona dypalëshe”, tha Blinken, duke paralajmëruar se Shtetet e Bashkuara do të vazhdojnë ta vëzhgojnë çdo



lëvizje të Qeverisë së Gjeorgjisë. Sipas ligjit, i cili nxiti protesta disajvëshe që u shtypën dhunshëm nga autoritetet, mediet dhe organizatat joqeveritare do të detyrohen të regjistrohen si “ndjekëse të interesave të një pushteti të huaj”,

nëse më shumë se 20 për qind e të hyrave të tyre janë financim nga jashtë.

Gjeorgjia e mori statusin e kandidatit për anëtarësim në BE më 14 dhjetor, por ende nuk i ka nisur bisedimet me bllokun të cilat mund të zgjasin me vite.

Partia në pushtet, Ëndrra Gjeorgjiane, ka ngulur këmbë se mbetet e përkushtuar për t’iu bashkuar institucioneve perëndimore dhe se ligji ka për qëllim vetëm rritjen e transparencës për financimin e OJQ-ve.

GjND-ja urdhëron Izraelin që “menjëherë ta ndalë” ofensivën në Rafah

HAGË, 24 MAJ - Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GjND) ka urdhëruar të premtën Izraelin që “menjëherë ta ndalë” ofensivën e tij ushtarake në Rafah, në jug të Gazës. Sipas GjND-së, Izraeli duhet të ndalë edhe çdo veprim tjetër në Rafah, që mund ta përkeqësojë jetesën e palestinezëve në Rafah të Gazës.

Afrika e Jugut i kishte kërkuar gjykatës, me seli në Hagë, që ta urdhërojë ndalimin e ofensivës izraelite në Rafah dhe tërheqjen e trupave nga i gjithë Rripi i Gazës.

GjND-ja, që njihet edhe si Gjykata Botërore, është organi më i lartë ligjor i Kombeve të Bashkuara, i themeluar në vitin 1945 për t’i trajtuar



mosmarrëveshjet midis shteteve. Nuk duhet të ngatërrohet me Gjykatën

Ndërkombëtare Penale (GJNP), të bazuar në traktat, gjithashtu në Hagë, e cila trajton rastet e

krimeve të luftës kundër individëve.

Kolegji prej 15 gjyqtarësh i GjND-së, i cili zgjerohet nga një gjyqtar shtesë i zgjedhur nga Izraeli në këtë rast, sepse tashmë ka një gjykatës nga Afrika e Jugut - merret me mosmarrëveshjet kufitare dhe gjithnjë e më shumë çështje të ngritura nga shtetet që akuzojnë të tjerët për shkelje të detyrimeve të Traktatit të OKB-së.

Afrika e Jugut dhe Izraeli janë nënshkrues të Konventës së Gjenocidit të vitit 1948 që i jep GjND-së juridiksionin për të vendosur rreth mosmarrëveshjeve mbi traktatin. Ndërsa çështja ka të bëjë me territoret palestineze të pushtuara nga Izraeli,

palestinezët nuk kanë asnjë rol zyrtar në procedurë.

Të gjitha shtetet që e kanë nënshkruar Konventën e Gjenocidit janë të detyruara të mos kryejnë gjenocid dhe ta parandalojnë dhe ndëshkojnë atë. Traktati e përkufizon gjenocidin si “akte të kryera me qëllim për të shkatërruar, tërësisht ose pjesërisht, një grup kombëtar, etnik, racor ose fetar”. Dosja fillestare prej 84-faqesh, e dorëzuar nga Afrika e Jugut tre muaj pas luftës, thotë se duke varë palestinezët në Gaza, duke u shkatërruar atyre lëndime të rënda mendore dhe trupore dhe duke krijuar kushte për jetën “të llogaritura për të sjellë shkatërrimin e tyre fizik”, Izraeli po kryen gjenocid ndaj tyre.

ShBA-ja dhe BE-ja, mekanizëm të përbashkët për luftimin e propagandës në Ballkan

UASHINGTON, 24 MAJ - Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian kanë lansuar Mekanizmin e Koordinuar për Ballkanin Perëndimor, që fokusohet ekskluzivisht në luftimin e manipulimit të informacionit nga shtetet e huaja dhe ndikimit (FIMI), që përfshin dezinformimin dhe propagandën.

Ky mekanizëm, sipas Departamentit Amerikan të Shtetit, do ta forcojë integritetin e informacionit në Ballkanin Perëndimor. “Mekanizmi do t’i fuqizojë partnerët që të bëhen të aftë t’i adresojnë vetë kërcënimet e FIMI-it dhe të punojnë së bashku për ta zvogëluar aftësinë e Rosisë dhe të

Republikës Popullore të Kinës për të kryer fushata propagande dhe të manipulimit të informacionit në rajon”, njoftoi DASH-i. Mekanizmi që u lansua u krijua pas një takimi të zhvilluar muajin e kaluar në Belgjikë të Këshillit Ministror të ShBA-së dhe të BE-së për tregti dhe teknologji.



Avancimi i statusit të Kosovës në agjendën e Asamblesë Parlamentare të NATO-s



PRISHTINË, 24 MAJ - Kosova do të jetë në agjendën e Asamblesë Parlamentare të NATO-s, e cila do të mbledhet këtë fundjavë në Sofje të Bullgarisë. Me këtë rast, Kuvendi i Kosovës synon ta avancojë statusin nga vëzhgues, në anëtar të asocuar të kësaj organizate.

Në komunikatën e Asamblesë Parlamentare të NATO-s thuhet se deputetët e saj, mes të tjerash, "do të vendosin për kërkesat e Maltës dhe të Kuvendit të Kosovës për t'u bërë delegacione të anëtarëve të asocuar". "Sfidat e vazhdueshme në Ballkanin Perëndimor do të trajtohen, ashtu si edhe strategjitë për mbështetjen e partnerëve në rrezik dhe për rritjen e angazhimit me Jugun Global", thuhet në komunikatë.

Autoritetet e Kosovës njoftuan qysh në mars se Komisioni i Përhershëm i Asamblesë Parlamentare të NATO-s e ka avancuar statusin e Kuvendit të Kosovës në këtë trup, shkruan REL.

Në Serbi, Instituti Ndërkombëtar për Siguri u angazhua për ta penguar avancimin e Kosovës në këtë organizatë. Në një thirrje drejtuar asaj, ai tha se konsideron se dhënia e statusit të anëtarit të asocuar Kuvendit të Kosovës "do të ishte e dëmshme si për Asamblenë Parlamentare të NATO-s, ashtu edhe për proceset e stabilizimit dhe integrimin euroatlantik të Ballkanit Perëndimor". "Demokracia në Kosovë nuk është funksionale. Institucionet e

saj janë të ngarkuara me një nivel jashtëzakonisht të lartë të korrupsionit dhe praktikave të tjera jodemokratike, ndërsa të drejtat e komuniteteve pakicë, veçanërisht ato serbe, nuk mbrohen", pretendoi organizata me seli në Beograd.

Serbia, e cila nuk e njeh pavarësinë e Kosovës, angazhohet vazhdimisht në fushata lobuese kundër Kosovës, së voni edhe kundër anëtarësimit të saj në Këshillin e Evropës.

Organizata serbe tha, po ashtu, se nëntë anëtarët aktualë të asocuar të Asamblesë Parlamentare të NATO-s janë nga "vende të pavarura dhe të njohura ndërkombëtarisht" dhe se "dhënia e të njëjtit status Kuvendit të Kosovës do të ishte një precedent i rrezikshëm".

Si funksionon Asambleja Parlamentare e NATO-s?

Asambleja Parlamentare e NATO-s është institucionalisht e ndarë nga NATO-ja, por shërben si një lidhje e rëndësishme mes NATO-s dhe parlamenteve të vendeve anëtare. Ajo përbëhet nga 281 delegatë nga të 32 vendet anëtare të NATO-s.

Përveç tyre, në aktivitete të saj marrin pjesë edhe delegatë nga 9 vende të asocuara, 4 vende të asocuara mesdhetare, si dhe 8 delegacione vëzhguese parlamentare.

Anëtarët e asocuar - çfarë synon të bëhet edhe Kosova - mund të paraqesin rezoluta dhe ndryshime në rezoluta. Gjithashtu, mund të shërbejnë si raportues specialë të asocuar në komitete, për t'i paraqitur perspektivat e tyre në raportet NATO-Asamble Parlamentare. Megjithatë, ata nuk kanë të drejtë të votojnë për raportet, rezolutat apo udhëheqjen e Asamblesë dhe as nuk kontribuojnë në buxhetin e saj.

Aktualisht, anëtare të asocuara janë nëntë - në mesin e tyre edhe Serbia dhe Bosnjë-Hercegovina.

Kuvendi i Kosovës prej vitesh është delegacion vëzhgues me dy ulëse. Me ngritjen e nivelit të përfaqësimit do të zgjerohej edhe delegacioni pjesëmarrës i Kosovës.

Në takimin në Sofje pjesëmarrësit do të priten nga sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, dhe zyrtarë të tjerë të lartë të NATO-s dhe të shtetit bullgar. Ata do të diskutojnë për tema që lidhen me mbrojtjen dhe sigurinë euroatlantike, me fokus në mbështetjen për Ukrainën dhe prioritetet e samitit të sivjetmë të NATO-s, i cili do të mbahet në korrik në Uashington. "Gjatë seancës, Asambleja pritet ta përforcojë qëndrimin e saj të palëkundur për luftën e pajustificuar, të paprovokuar dhe brutale të Rusisë kundër Ukrainës, të diskutojë për ofrimin e ndihmave të menjëhershme

dhe afatgjatë për Ukrainën, si dhe të miratojë një deklaratë për mbështetjen e Ukrainës deri në fitoren e saj", bëri me dije Asambleja Parlamentare e NATO-s.

Kosova dhe NATO-ja

Pasi Rusia ka nisur pushtimin në shkallë të plotë të Ukrainës, në shkurt të vitit 2022, autoritetet e Kosovës kanë kërkuar anëtarësim të përshpejtuar në NATO. "Anëtarësimi i përshpejtuar i Kosovës në NATO dhe vendosja e bazës së përhershme të forcave amerikane janë nevojë imediate për garantimin e paqes, sigurisë dhe stabilitetit në Ballkanin Perëndimor dhe më gjerë", ka thënë ministri i atëhershëm i Mbrojtjes në Kosovë, Armend Mehaj. NATO-ja nuk e ka komentuar këtë kërkesë të Kosovës, por ka siguruar se misioni i saj paqeruajtës në vend, KFOR, "mundëson trajtimin e menjëhershëm të çdo zhvillimi që mund të ndikojë në situatën e sigurisë". Forcat e NATO-s janë të pranishme në Kosovë qysh në qershor të vitit 1999, pas përfundimit të luftës dhe tërheqjes së forcave serbe.

Kosova kufizohet me tri shtete anëtare të NATO-s: Shqipërinë, Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut.

Në radhët e NATO-s janë katër shtete që ende nuk e njohin pavarësinë e Kosovës: Greqia, Spanja, Rumania dhe Sllovakia.



ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E KOMBEVE TË BASHKUARA KA MIRATUAR REZOLUTËN PËR GJENOCIDIN NË SREBRENICË

Dita Ndërkombëtare e Përkujtimit të Gjenocidit në Srebrenicë vendoset në kalendarin zyrtar të OKB-së

Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara e ka miratuar një rezolutë për ta kujtuar çdo vit gjenocidin e kryer më 1995 në Srebrenicë të Bosnjë-Hercegovinës. Rezoluta është miratuar me 84 vota për. Dita Ndërkombëtare e Përkujtimit të Gjenocidit në Srebrenicë, 11 korriku, tashmë është shënuar në kalendarin zyrtar në faqen e OKB-së

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 24 MAJ - Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi rezolutën që e shpall 11 korrikun Ditë Ndërkombëtare të Përkujtimit të Viktimave të Gjenocidit në Srebrenicë.

Forcat serbe në këtë rajon lindor të Bosnjë-Hercegovinës vranë mbi 8 000 burra dhe djem boshnjakë në korrik të vitit 1995.

Rezoluta, e bashkësponsorizuar nga Gjermania dhe Ruanda, kaloi me 84 vota për. Kundër ishin 19, ndërsa abstenime 68. Dokumenti nxiti reagime të furishme në Serbi dhe në rajonin serb të Bosnjës, Republika Sërpska, ku udhëheqësit thanë se ai do ta etiketojë gjithë popullin serb si "mbështetës" të vrasjeve masive.

Duke folur para Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së,

ambasadorja e Gjermanisë, Antje Leendertse, tha se "rezoluta nuk është e drejtuar kundër askujt - as kundër Serbisë, anëtare e vlefshme e kësaj organizate". "Rezoluta shënjestron vetëm autorët e gjenocidit", tha Leendertse.

Në adresimin e tij, presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, tha se bëhet fjalë për një "rezolutë shumë të politizuar" që "nuk do t'i kontribuojë pajtimit as në Bosnjë-Hercegovinë, as në rajon".

Rezoluta për Srebrenicën nuk e përmend as Serbinë, as Republikën Sërpska.

Ndër të tjera, ajo bën thirrje për "dënimin pa rezerva të çdo mohimi të gjenocidit në Srebrenicë, si dhe të veprimeve që i madhërojnë të dënuarit për krime lufte, përfshirë edhe ata që janë përgjegjës për gjenocidin". "E vërteta fitoi", shkroi në "Facebook" kryesuesi i Presidencës së Bosnjës, Denis

Beqiroviq.

Për udhëheqësin e Republikës Sërpska, Millorad Dodik, rezoluta "dështoi" pasi, siç tha ai, "rreth 110 vende nuk votuan, ishin kundër ose abstenuan".

"Plani" për t'i ngarkuar serbët me gjenocid, "nuk pati sukses", sipas tij.

Përveç Serbisë, vendet e rajonit - Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Kroacia - votuan për. Nga vendet e Bashkimit Evropian, Hungaria ishte kundër, ndërsa Greqia, Sllovakia dhe Qiproja abstenuan.

Kina, Rusia, Bjellorusia, Kuba dhe Nikaragua ishin në mesin e atyre që votuan kundër.

Në një postim në platformën "X", Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Sarajevë tha se "rezoluta nuk shënjestron asnjë shtet anëtar" dhe "nuk ngarkon me përgjegjësi kolektive asnjë grup njerëzish". "Siç e bën të qartë rezoluta, ne të gjithë e

kemi detyrim t'i pranojmë faktet, ta mësojmë të vërtetën, t'i nderojmë viktimat, t'i mbështesim përpjekjet e vazhdueshme për t'i gjetur dhe identifikuar viktimat dhe për t'i ndjekur penalisht autorët. Këta hapa janë thelbësorë për pajtimin", shkroi Ambasada Amerikane.

Gjermania dhe Ruanda ishin "sponsorueset" kryesore të rezolutës për Srebrenicën, përkatësisht shtetet që bashkërisht e iniciuan dhe hartuan tekstin e saj.

Më pas, 32 shtete anëtare të OKB-së u bënë "bashkësponsoruese", apo vende që morën përsipër detyrën e prezantimit të draftit para 193 shteteve anëtare të kësaj organizate.

Serbia lloboi në mënyrë aktive kundër miratimit të rezolutës, ndërsa pak orë para se të niste debati në Asamblesë të Përgjithshme, Republika

Sërpska tha se ofron një marrëveshje për “ndarjen paqësore” të Bosnjë-Hercegovinës. “Ne e ofrojmë atë nëse na konsideroni komb gjenocidal - e nuk jemi. Atëherë, nuk kemi përse të jetojmë së bashku”, tha kryeministri i Republikës Sërpska, Radovan

Vishkoviç. Ai nuk dha ndonjë detaj për hapat që do të ndërmerren. Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në Hagë e karakterizoi krimin në Srebrenicë si gjenocid në vitin 2007. Ajo konstatoi se Serbia nuk ishte përgjegjëse për aktin e

as bashkëpunëtore, por deklaroi se ajo nuk bëri asgjë për ta parandaluar atë. Për gjenocidin e kryer, deri më tash, janë dënuar më shumë se 50 persona me rreth 700 vjet burg. Në mesin e tyre janë edhe presidenti i kohës së luftës i Republikës Sërpska, Radovan

KMDLNj: Srebrenica, vendi ku drejtësia e mundi gjenocidin

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut ka reaguar pasi Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi rezolutën që e shpall 11 korrikun Ditë Ndërkombëtare të Përkujtimit të Viktimave të Gjenocidit në Srebrenicë.

KMDLNj ka theksuar se ndonëse kjo rezolutë nuk prodhon efekte juridike dhe nuk është detyruese - obliguese, për të drejtat e njeriut është një e arritur e madhe për faktin se qartë e cilëson krimin në Srebrenicë si gjenocid. “Në korrik të vitit 1995 ushtria, policia dhe paramilitarët serbë nën komandën e gjeneralit Ratko Mlladiq, tani i dënuar për krime lufte dhe gjenocid vranë dhe masakruan mbi 8000 boshnjakë për shkak të përkatësisë etnike dhe fetare. Boshnjakët e ekzekutuar ishin nën mbrojtje të

ushtarëve holandezë të forcave të Kombeve të Bashkuara të cilat ia dorëzuan kriminelit të luftës, Ratko Mlladiq, gjeneral i ushtrisë jugosllave. Disa qindra boshnjakë konsiderohen të zhdukur deri më sot. Gjykata Ndërkombëtare Penale në Hagë e cilësoi këtë krim si gjenocid mirëpo nuk e bëri përgjegjëse Jugosllavinë dhe Serbinë për këtë. Me nismën e disa shteteve, Kombet e Bashkuara miratuan një Rezolutë me të cilën 11 korriku shpallet si Ditë Ndërkombëtare e Përkujtimit të Gjenocidit që ndodhi në Srebrenicë. Ndonëse kjo rezolutë nuk prodhon efekte juridike dhe nuk është detyruese - obligative, për të drejtat e njeriut është një e arritur e madhe për faktin se qartë e cilëson krimin në Srebrenicë si gjenocid duke adresuar saktë përgjegjësinë për këtë krim dhe të tjera në hapësirat

e ish-Jugosllavisë sikur që është një satisfacion moral për viktimat në Srebrenicë dhe të gjitha viktimat tjera në hapësirat e ish-Jugosllavisë. Shënimi i kësaj dite në kalendarin e Kombeve të Bashkuara si përkujtim i Gjenocidit në Srebrenicë forcon dhe ruan kujtesën historike ndërkombëtare për krime të tmerrshme e që identifikohen me Gjenocidin në Srebrenicë”, është thënë në reagimin e KMDLNj-së. Miratimin e kësaj rezolute KMDLNj e konsideron si shumë të rëndësishme që të mos harrohet e kaluar dhe një porosi për ata që planifikojnë krime në të ardhmen se këto krime nuk do të mbesin të pahetuara dhe të padënuara, qoftë edhe moralisht. KMDLNj shpreson dhe pret se në një të ardhme të afërt të miratohen Rezoluta për Gjenocidin në Gaza dhe në Ukrainë.

Haradinaj: Pa një rezolutë për gjenocidin në Kosovë, e vërteta dhe drejtësia mbeten të përgjysmuara

Ish-kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë se Rezoluta e OKB-së për Srebrenicën është një hap i madh i pranimit të së vërtetës për mizoritë serbe në Bosnjë. Ai ka theksuar se pa një rezolutë të Kombeve të Bashkuara për krimet e gjenocidin në Kosovë, e vërteta dhe drejtësia për mijëra viktimat mbesin përgjysmë. “Pa një rezolutë të Kombeve të Bashkuara, për krimet e gjenocidin në Kosovë, e vërteta dhe drejtësia për mijëra viktimat, mbeten përgjysmë. Autorët e krimit e gjenocidit, të

kudondodhur, duhet ta marrin dënimin. Varrezat masive, masakrat, ekzekutimet e mijëra qytetarëve, dhunimet dhe përndjekja e një milion shqiptarëve nga shtëpitë e tyre, s’mund të kenë emër tjetër përpos gjenocid. Rezoluta e OKB-së për Srebrenicën është një hap i madh i pranimit të së vërtetës për mizoritë serbe në Bosnjë që duhet përshëndetur. E vërteta dhe drejtësia do të jenë më të plota atëherë kur të pranohet se edhe në Kosovë pati gjenocid”, ka shkruar Haradinaj në “Facebook”.

Karaxhiq, dhe komandanti i përgjithshëm i ushtrisë së atëhershme serbe, Ratko Mlladiq. Në vitin 2003 Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi një rezolutë të ngjashme, e cila e shpalli 7 prillin Ditë Ndërkombëtare të Reflektimit mbi Gjenocidin në Ruandë. Në këtë vend të Afrikës Qendrore gjenocidi ndodhi në

vitin 1994 gjatë një lufte civile. Për vetëm 100 ditë ekstremistët Hutu vranë rreth 800 mijë njerëz, kryesisht anëtarë të pakicës Tutsi dhe kundërshtarë politikë. Rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme nuk janë ligjrisht detyruese. Ndryshe nga rezolutat e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, ato më së shpeshti “u bëjnë thirrje” shteteve anëtare të veprojnë.

Shtyhet debati në Kuvend për Qeverinë Kurti



Prishtinë, 24 maj- Kuvendi i Kosovës ka dështuar të premten që të zhvillojë seancën për të diskutuar qeverisjen e kryeministrit të Kosovës, Albin Kurtit, në mungesë të deputetëve dhe dakordimit mes partive. Seanca është shtyrë, por nuk është bërë e ditur data e re. Shefi i Grupit parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AA) Besnik Tahiri, ka

thënë se seanca është kërkuar për të zhvilluar “një ballafaqim të vërtetë” mes opozitës dhe kryeministrit. Vetë Kurti ka qenë i pranishëm në seancë. “Grupi parlamentar i AAK-së, tash e tre muaj e ka dërguar në kryesi një kërkesë për një debat për tre vjetët e qeverisë. Në diskutim me grupet parlamentare dhe në mungesë të deputetëve për një temë kaq të rëndësishme, një

ballafaqim i vërtetë mes opozitës dhe kryeministrit nuk do të duhej të ndodhte pa një dakordim të plotë. Andaj po e shtyjme këtë debat”, ka thënë ai. Qeveria e Kurtit, e cila është betuar në mars të vitit 2021, ka hyrë në vitin e katërt të qeverisjes. Mandati i saj përfundon në fillim të vitit të ardhshëm. Thirrja e kësaj seance është bërë

teksa po zhvillohen bisedime për mbajtje të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare. Vetë Kurti ka thënë se është i interesuar për të diskutuar për datën e re të zgjedhjeve. Megjithatë, krerët e partive opozitare kanë opsione të ndryshme për mënyrën se si duhet të shkohet drejt zgjedhjeve të reja. Shefja e Grupit parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, Mimoza

Kusari-Lila, u ka thënë gazetarëve, pas seancës se, “është e paimagjinueshme të pritet shpërndarja e Kuvendit kur për debat të qeverisjes ka aq pak deputetë në sallë”. “Në aspektin legjislativ, pushteti është i gatshëm të vazhdojë mandatin deri në fund, dhe për të përmbushur agjendën legjislative më shumë se secila legjislaturë deri më tash”, ka thënë ajo.

REAGIM I KMDLNJ-së

Qëndrimi dhe votimi dyfytës i deputetëve për marrëveshjen me Danimarkën

Para një jave deputetët e Kuvendit të Kosovës e rrëzuan marrëveshjen për shitblerje të të burgosurve midis Danimarkës dhe Kosovës. Në ndërkohë, qeveria e Kosovës e riktheu në Kuvend këtë Marrëveshje raciste, të turpshme dhe diskriminuese që legalizon trafikimin me qenie njerëzore duke mundësuar në mënyrë kriminale zbatimin e standardeve të dyfishta të trajtimit të të burgosurve brenda një vendi. Qeveria e Kosovës, me përkrahjen klienteliste të deputetëve të joshur me privilegje pas zgjedhjeve të parakohshme, legalizoi dy standarde të të drejtave të njeriut për të burgosur, shumë të larta për të burgosurit e blerë nga Danimarka e që asnjëri nuk është danez kurse, fare modeste për të burgosurit kosovarë. Po legalizohen dy sisteme korrektuese brenda një shteti që deklarohet i pavarur dhe sovran kurse, në anën tjetër e shesin një pjesë të territorit të Kosovës dhe sovranitetit për një afat 10 vjeçar. Për 10 vjet Burgu i Gjilanit, me hapësirën rrethuese do të konsiderohet territor ekstraterritorial ku institucionet e Kosovës nuk do të kenë qasje pa lejen e administratorit racist danez. Të paraburgosurit dhe të dënuarit kosovarë do të zhvendosen në qendra tjera duke e rritur mbipopullimin e atyre qendrave dhe duke i bërë të vështirë vizitat familjare e që është në kundërshtim të plotë me të drejtat e njeriut të personave të privuar nga liria, mbështetur në standardet ndërkombëtare. Sot, po ata



deputetët e Kuvendit të Kosovës, pa u krijuar asnjë rrethanë e re që do ta arsyetonte këtë votim, e votuan këtë Marrëveshje raciste dhe diskriminuese duke shkelur rëndë të drejtat e të burgosurve kosovarë dhe duke krijuar trajtim superior për të burgosurit e importuar nga Danimarka që janë të stigmatizuar në Danimarkë nga pozicioni racist për faktin se nuk janë danezë dhe kryesisht janë të besimit islam. Ministria e Drejtësisë e Kosovës ka negociuar këtë Marrëveshje nga pozita e të nënshtruarit duke mos e

informuar publikun kosovar e as deputetët për përmbajtjen, pasojat dhe rreziqet që paraqet për sigurinë e vendit. Kjo marrëveshje është marrëveshje e territ, marrëveshje e korrupsionit, e pamoralshme, e bërë dhe e votuar nga persona të papërgjegjshëm që kanë të theksuar mungesën e integritetit profesional prandaj KMDLNJ thërret votuesit që të mendojnë mirë kur të votojnë në zgjedhjet, kurdo që ato do të mbahen. Komiteti për Parandalimin e Torturës dhe trajtimit Degradues i Kombeve të

Bashkuara ka gjetur shumë shkelje të mundshme të drejtave të njeriut prandaj ka kërkuar nga Danimarka që të mos e zbatojë Marrëveshjen. Për institucionet e drejtësisë të Kosovës, të hendikepuara skajshmërisht profesionalisht, kërkesa e OKB drejtuar Danimarkës nuk i bënë përshtypje sikur as deputetëve të Janusit të Kuvendit të Kosovës. Qeveria e Kosovës ka blerë votat e opozitës duke premtuar zgjedhje të parakohshme që paraqet korrupsion klasik dhe të dënueshëm. KMDLNJ- ë thërret

familjet e të burgosurve të Burgut të Gjilanit të kundërshtojnë transferimin në qendra tjera e që e bëjnë kundër vullnetit të tyre sikur që edhe të burgosurit nga Danimarka po transferohen dhunshëm dhe kundër vullnetit të tyre. KMDLNJ kërkon që të burgosurit kosovarë të kenë të drejta të njëjta, kushte të njëjta dhe trajtim të njëjtë me të burgosurit nga Danimarka. Nëse jo, atëherë ata duhet të kërkojnë realizimin e tyre duke përdorur të gjitha mjetet e lejuara në këto raste. Në realizimin e të drejtave të tyre duhet të përkrahen nga organizatat për të drejtat e njeriut, vendore dhe ndërkombëtare sikur edhe nga legjislatura e atëhershme e Kuvendit të Kosovës për të cilën KMDLNJ - shpreson të jetë më e përgjegjshme dhe më profesionale. Duke e kundërshtuar këtë votim klientelist dhe korruptiv të Marrëveshjes raciste dhe diskriminuese, KMDLNJ ia kujton opinionit se faturat ndëshkuese do të vijnë shpejtë dhe do ta kenë një çmim të lartë për sigurinë dhe sovranitetin e vendit. KMDLNJ, që nga fillimi ka kundërshtuar këtë Marrëveshje dhe është angazhuar të mos votohet, gjithnjë në mbrojtje të drejtave të njeriut të personave të privuar nga liria kosovarë sikur edhe të atyre fatkëqijve që do të përzihen nga Danimarka shkaku i përkatësisë etnike dhe besimit. Me këtë votim Kosova po bëhet pjesë aktive e shkeljeve të drejtave të njeriut të personave të privuar nga liria.



Përfundoi dëgjimi i katërt publik buxhetor në Rahovec

RAHOVEC, 24 MAJ - Në ambientin e parkut të qytetit të Rahovecit është mbajtur të premten dëgjimi publik buxhetor për përgatitjen e Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitin 2025. Hapjen e dëgjimit e bëri kryetari i komunës, Smajl Latifi, duke e elaboruar buxhetin, kufijtë buxhetorë, të hyrat e komunës, si dhe foli për synimet kryesore të ekzekutivit. Informatat më të hollësishme rreth buxhetit i dha drejtori i Financave, Afrim

Limani, i cili foli rreth qarkores së parë buxhetore, për rritjen e buxhetit dhe planet specifike. Dëgjimi shkoi sipas planifikimit, me kryetarë të fshatrave dhe lagjeve urbane, të cilët parashtruan kërkesa dhe pyetje të ndryshme sipas prioriteteve. Grupi punues i ka evidentuar të gjitha pyetjet dhe diskutimet dhe në raportin final do t'i japë arsyetimet për kërkesat të cilat u parashtruan në dëgjim.



Djali i Afrim Bunjakut punësohet në ndërmarrjen publike të Vushtrrisë

VUSHTRRI, 24 MAJ - Jetlum Bunjaku, djali i heroit, ish-policit Afrim Bunjaku, është punësuar në ndërmarrjen publike lokale "Përparimi" në Vushtri. Lajmin e ka dhënë kryetari i komunës së Vushtrrisë, Ferit Idrizi. "Shumë i gëzuar që sot isha prezent në nënshkrimin e kontratës për fillimin e punës në kompaninë lokale "NPL PËRPARIMI", të Jetlum Bunjakut, djalit të

heroit të Kosovës Afrim Bunjaku. Jetlum paç suksese, e punë të mbarë!", ka shkruar Idrizi në "Facebook". Rreshteri Afrim Bunjaku është vrarë në veri të Kosovës derisa ishte në krye të detyrës. Ai është vrarë nga grupe të armatosura serbe, të cilat kishin hyrë ilegalisht në Kosovë. Vrasja e tij është dënuar ashpër, ndërsa ai është shpallur hero i Kosovës.

BQK-ja anëtarësohet në Shoqatën Evropiane të Shtëpive të Kliringut të Pagesave (EACHA)

PRISHTINË, 24 MAJ - Zëvendësguvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Dardan Fusha, dhe presidenti i Shoqatës Evropiane të Shtëpive të Kliringut (EACHA), Jose Luis Langa, nënshkruan anëtarësimin e BQK-së në këtë organizatë pas votimit të anëtarëve të saj gjatë Takimit Plenar të organizuar në kuadër të Forumit të Pagesave në Sofje të Bullgarisë.

Anëtarësimi në EACHA paraqet një hap të rëndësishëm, duke marrë parasysh projektet dhe reformat në proces lidhur me digjitalizimin e shërbimeve të pagesave. Ky anëtarësim ofron një mundësi për të mësuar nga përvojat dhe njohuritë e vendeve të tjera mbi procesin e anëtarësimin në SEPA dhe qasjes në TIPS. Gjithashtu, do ta lehtësojë procesin e identifikimit dhe adaptimit të një zgjidhje për procesimin e pagesave të shpejta në Republikën e Kosovës dhe do ta lehtësojë qasjen e bankave dhe



ofruesve të tjerë të shërbimeve të pagesave në shtëpitë e kliringut në Evropë, duke mbështetur qëllimin strategjik të BQK-së për modernizimin e sistemeve të pagesave dhe integrimin në SEPA. EACHA ka anëtarë nga 25 vende të ndryshme evropiane, duke

përfshirë disa banka qendrore si ajo e Gjermanisë (Deutsche Bundesbank) dhe Italisë (Banca D'Italia), si dhe disa nga operatorët dhe infrastrukturat më të mëdha evropiane të pagesave në pronësi të bankave. Kjo organizatë shërben si një forum për t'i

mbështetur anëtarët e saj në zbatimin e Rregullave dhe Standardeve të Pagesave të Këshillit Evropian të Pagesave (EPC), si dhe për të mësuar nga përvojat e njëri-tjetrit në zhvillimin dhe adoptimin e skemave, sistemeve dhe infrastrukturave të

reja të pagesave. Për më tepër, EACHA përfaqëson nevojat e anëtarëve të saj në institucionet evropiane, duke mundësuar shkëmbimin e informacionit, diskutimin e çështjeve me interes të përbashkët, rrjetëzimin dhe zhvillimin e standardeve për ta promovuar ndërveprimin e sistemeve të pagesave me vlerë të vogël në zonën SEPA. EACHA mban kontakte të afërta me BE-në, BQE-në, EPC-në dhe institucione të tjera evropiane. Kjo platformë do ta ndihmojë BQK-në dhe ofruesit e shërbimeve të pagesave në adaptimin e standardeve të BE-së dhe përgatitjen e tregut për integrim me skemat dhe sistemet e pagesave të BE-së. Gjithashtu, do t'i mundësojë BQK-së të jetë e përfshirë për së afërmi në iniciativat dhe zhvillimet e reja në BE, për mbështetjen e avancimit të tregut të pagesave në Republikën e Kosovës.

Kosova në Uashington blen objekt për ambasadë

UASHINGTON, 24 MAJ - "Objekti i Ambasadës së Kosovës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, tash është pronë e Kosovës dhe shtëpi e përhershme e Republikës sonë atje. Me një arkitekturë moderne, karshi Katedrales Kombëtare të Uashingtonit të stilit neo-gotik anglez, ndërtesën e ambasadës sonë tani e gjeni në rrugën e Massachusetts, apo siç njihet ndryshe 'Rruga e Ambasadeve', ka thënë kryeministri Albin Kurti. Ndërkaq ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla, e cila mori pjesë në ceremoninë e përfundimit të objektit të ri të Ambasadës së Kosovës në Uashington, ka theksuar se këtë vit do ta festojmë 25-vjetorin e çlirimit të Kosovës dhe çdo fëmijë në Kosovë e di se pa angazhimin e partnerëve tanë, aleatëve dhe miqve tanë 25 vjet më parë, pa angazhimin edhe të NATO-s për ta ndaluar gjenocidin



në Kosovë, ne nuk do të ishim këtu sot midis jush. "Ky angazhim i miqve tanë shpëtoi më shumë se 100 000 jetë njerëzish në Kosovë dhe solli një të ardhme të

ndryshme për të gjithë rajonin tonë. Kosova është shteti më pro amerikan në botë, prandaj kjo ambasadë që po inaugurojmë sot është jo vetëm një objekt, por një

mesazh i fuqishëm", ka thënë ministria Gërvalla. Ambasadori i Kosovës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Ilir Dugolli, para të pranishmëve tha

se kjo ambasadë shërben si një dëshmi e një lidhjeje të fortë, të qëndrueshme, të pathyeshme që ekziston midis vendeve dhe kombeve tona si dhe një dëshmi e sukseseve të përbashkëta që kemi arritur deri tani.

Nga ana tjetër, ndihmësekretari amerikan i Shtetit për Evropën dhe Euroazinë, James O'Brien, deklaroi se ShBA-ja ka qenë dhe do të jetë gjithmonë mike dhe partnere e përkushtuar për Kosovën. Ai theksoi se ky sukses i Kosovës, vendosja e kësaj ambassade fare pranë vendit ku kishte filluar karrierën e saj, do ta gëzonte pa masë ish-sekretaren e shtetit, Madeleine Albright. "Zemra e saj do të shpërthente nga gëzimi kur ta shihte kështu Kosovën, për të cilën gjithmonë thoshte se ishte gjëja për të cilën ishte më së shumti krenare", ka deklaruar ndihmësekretari O'Brien.

Policia në Shqipëri i arreston katër persona për trafikim të armëve nga Kosova

TIRANË, 24 MAJ - Policia e Shqipërisë njoftoi të premten se i ka arrestuar katër persona në një fshat të kryeqytetit Tiranë, të cilët dyshohen për trafikim të armëve të zjarrit nga Kosova.

Në një njoftim për medie, policia tha se të gjithë të arrestuarit, të moshës 20-28 vjeçe, janë banorë të Kosovës.

Gjatë një aksioni policor në vendparkimin e një terminali autobusësh në periferi të kryeqytetit shqiptar, në fshatin Lundër, policia gjeti dhe sekuestroi një çantë me armë dhe municion. Sipas policisë, një 28-vjeçar me inicialet B. K.


dyshohet se kishte futur në një autobus që vinte nga Kosova drejt Shqipërisë një çantë brenda së cilës u gjetën 10 pistoleta, 10 krehra dhe sasi municioni luftarak.

Një video e publikuar në "Facebook" nga policia shqiptare, shfaq momentin e arrestimit të të dyshuarve, si dhe armët e sekuestruara gjatë aksionit. "Më pas, ai dhe një prej bashkëpunëtorëve të tij, kanë ndjekur me automjetin e tyre autobusin gjatë gjithë itinerarit", thuhet në njoftim.

Policia tha se, pas hetimit, erdhi në përfundim se armët po

trafikoheshin me qëllim për t'u shitur në vlerat "1 500-3 000 euro". "Po nga verifikimet e kryera dyshohet se pronari i linjës së autobusëve, së bashku me shtetas të tjerë, ka trafikuar armë zjarri drejt Shqipërisë në disa raste", thuhet në njoftimin e policisë së Tiranës.

Në cilësinë e provës materiale u sekuestruan edhe një automjet dhe pesë celularë, tha policia. Në shkurt policia shqiptare i sekuestroi 46 kilogramë lëndë eksplozive që vinte nga Kosova dhe si të dyshuar për këtë i arrestoi tre të rinj nga qyteti jugor i Kosovës, Gjiilan.



Oda Amerikane kërkon ndërprerjen e ndërhyrjes së shtetit në tregun e karburanteve

PRISHTINË, 24 MAJ - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë shpreh shqetësimin e saj lidhur me ndërhyrjen e stërzgatur të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë të Republikës së Kosovës në tregun e derivateve të naftës.

Oda Amerikane beson se përcaktimi i çmimeve të produkteve të naftës shkel drejtpërdrejt parimet e një ekonomie të tregut të lirë, duke ndikuar negativisht në operacionet e kompanive që tregojnë karburantet e naftës, duke kërcënuar rrjedhimisht edhe qëndrueshmërinë e tyre ekonomike. “Ndërhyrjet e tilla paraqesin disa rreziqe për ndërmarjet e sektorit privat, duke përfshirë paqëndrue-

shmërinë financiare, çrregullimin e tregut, uljen e konkurrencës, ndërprerjet e zinxhirit të furnizimit dhe rreziqet ligjore dhe rregullative”, thuhet në reagimin e kësaj ode.

Oda Amerikane e konsideron të gabueshëm interpretimin nga ana e ministrisë Ligjin nr. 08/L-018 për Produkte të Naftës dhe Karburante të Ripërtërishme, duke vlerësuar se asnjëra nga rastet e cekura në nenin 15 të ligjit nuk vazhdon të jetë e zbatueshme. Oda Amerikane u kujton zyrtarëve më të lartë të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë se ekonomia e tregut me konkurrencë të lirë është bazë e rregullimit ekonomik të



Republikës së Kosovës. “Gjatë vlerësimit të kushtetutshmërisë së një akti të ngjashëm juridik, konkretisht të Ligjit nr. 08/L-179 për Masat e Përkohshme të Produkteve Themelore në Raste të Veçanta të

Destabilizimit në Treg, Gjykata Kushtetuese ka konstatuar se dispozitat e këtij ligji nuk ishin në përputhje me aktin më të lartë juridik të Republikës së Kosovës, duke e shpallur atë të pavlefshëm në tërësinë e tij. Bazuar në këto konkluzione,

Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë u bënë thirrje Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë së Kosovës që ta revokojnë menjëherë vendimin për përcaktimin e çmimit të naftës. Ky veprim do të demonstronte përkushtimin për respektimin e Kushtetutës, promovimin e sundimit të ligjit dhe shmangien e tendencave ndërhyrëse në ekonominë e tregut të lirë, duke shmangur në këtë mënyrë rreziqet me të cilat përballen kompanitë e sektorit privat, si dhe duke nxitur një mjedis biznesi më të qëndrueshëm dhe konkurrues”, theksohet në reagimin e Odës Ekonomike Amerikane.

IKD: Shteti vazhdon t'i përjashtojë pensionistët duke mos i harmonizuar pensionet me koston e jetesës siç ua garanton ligji

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 24 MAJ - Instituti i Kosovës për Drejtësi ka vlerësuar se Qeveria e Kosovës ka dështuar ta përlogarisë koston e jetesës së mijëra pensionistëve në mënyrë që t'i rrisë pensionet dhe t'i përshtatë me inflacionin. Ky mosharmonizim përbën shkelje të të drejtave të qindra mijëra pensionistëve dhe dështim për t'i mbrojtur të drejtat që ua garanton ligji. “Qytetarët e Kosovës, të cilët i kanë mbushur 65 vjet jetë, pavarësisht nga historia e tyre e punësimit, gëzojnë të drejtën e pensionit bazë, politikë pensionale e cila ishte vendosur si masë për zbutjen e varfërisë. Por, përkundër qëllimit të kësaj mase, si mjet jetik në luftën kundër varfërisë dhe mbrojtjes sociale të qytetarëve që kanë mbushur moshën e pensionit, ky qëllim nuk është përmbushur asnjëherë”, është thënë në reagimin e IKD-së.

Më tej thuhet se shuma e përcaktuar ndër vite ka qenë e pamjaftueshme për t'i mbuluar



shpenzimet minimale të përfuturësve. Për më tepër, institucionet e Kosovës, respektivisht Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale (MPMS) për vitet e mëhershme, tani Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) nuk kanë ndërmarrë hapa adekuatë dhe nuk kanë zbatuar legjislacionin në fuqi për caktimin e lartësisë së pensionit.

Sipas Ligjit për Skemat

Pensionale të financuara nga shteti, MFPT e ka për obligim që për secilin fundvit t'i propozojë Qeverisë së Kosovës lartësinë e pensionit për vitin e ardhshëm në pajtim me koston e jetesës dhe inflacionin. Në këtë kuptim pensionet duhet të harmonizohen me koston e jetesës duke rritur shumë e pensionit që duhet paguar me të njëjtën përqindje bazuar në Indeksin e Kostos së jetesës të

vitit paraprak. “Përkundër që është obligim ligjor, MFPT dhe Qeveria e Kosovës nuk propozuan dhe nuk morën vendim në pajtim me Ligjin për Skemat Pensionale të financuara nga Shteti dhe në pajtim me Ligjin mbi Metodologjinë e caktimit të lartësisë së pensionit bazë në Kosovë dhe caktimin e datës për sigurimin e pensioneve bazë. Mospërshtatja e pensioneve, duke e përlogaritur

koston e jetesës çdo vit, është shkelje e të drejtave të qindramijëra pensionistëve. Dështimi për t'i përshtatur pensionet me koston e jetesës është një dështim për t'i mbrojtur të drejtat që u ka garantuar ligji. Rrjedhimisht, kjo ka shkaktuar dhe vazhdon të shkaktojë situatë të vështirë jetese për këtë kategori që siguron jetesën bazuar në pensionin e shtetit”, ka vlerësuar IKD.

IKD-ja shpreh shqetësimin e thellë për moszbatimin e dy ligjeve themelore të cilat kanë në mbrojtje afërsisht 147 mijë pensionistë të Kosovës, të cilët mund të jenë në kufirin e varfërisë për shkak të mosveprimit të shtetit. “Shteti ka për obligim të ofrojë kujdes shëndetësor, strehim dhe shërbime shtesë për të siguruar standard mesatar të jetesës për pensionistët. Andaj, IKD kërkon nga MFPT dhe Qeveria e Kosovës, që t'i zbatojë të dy ligjet. Në të kundërtën, për interes publik ne do t'i shfrytëzojmë të gjitha procedurat ligjore që kjo çështje të adresohet”, thuhet në reagimin e IKD-së.

ATK-ja falënderon Woodcockin për kontributin e dhënë në fushën e hetimeve tatimore


PRISHTINË, 24 MAJ - Drejtori i përgjithshëm i ATK-së, Ilir Murtezaj, ka pritur në takim përfaqësuesin nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar, Simon Woodcock, në një takim falënderues. “Woodcock ka kontribuar në mënyrë të pazëvendësueshme për ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe logjistike të hetimeve tatimore”, ka bërë me dije drejtori i ATK-së, duke shtuar se takimi

përshtetës është një mundësi e shkëlqyer për të vlerësuar dhe reflektuar mbi përparimet e bëra falë përkushtimit dhe ekspertizës së tij. Falë bashkëpunimit të ngushtë me Woodcock dhe mbështetjes së pakursyer të Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar, ATK-ja ka arritur t'i forcojë kapacitetet në fushën e hetimeve tatimore, duke përmirësuar ndjeshëm

transparencën dhe efikasitetin në këtë sektor të rëndësishëm. Pjesë e këtij takimi ishin edhe Darren Partridge dhe Brian Dixon, gjithashtu edhe përfaqësuesi për çështje fiskale nga kjo ambasada. Gjatë takimit në fjalë u diskutua edhe për bashkëpunimin e mëtutjeshëm në mes të autoritetit tatimor dhe Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar.



A jetojmë në një Multivers?



Me aq sa dimë deri më sot, ekziston një pikë e vetme në zgjerim në kohën hapësinore, e populluar nga trilionat galaktika. Ky është Universi ynë. Nëse ka të tjerë, ne nuk kemi asnjë provë bindëse për ekzistencën e tyre. Po sikur ato të ekzistojnë?

Çfarë është një Univers?

Kozmologët kuptojnë më të masën totale të objekteve (dhe hapësirën midis tyre) që është zgjeruar ngadalë nga një vëllim shumë i përqendruar gjatë 13.77 miliardë viteve të fundit, duke u bërë gjithnjë e më kaotik me kalimin e kohës.

Tani ai shtrihet 93 miliardë vite dritë nga cepi në cep, të paktën bazuar në të gjitha gjërat e dukshme (dhe të padukshme) që mund të zbulojmë nga këtu në një farë mënyre. Përtej këtij kufiri, ekzistojnë ose gjëra që nuk mund t'i shohim, një hapësirë e pafundme e asgjësë, ose në skenarin e pamundur që e gjithë hapësira kthehet në vetvete, pra një vajtje-ardhje në një univers hipersferik.

Por nëse flasim për fizikën kuantike, një Univers mund t'i referohet të gjitha fushave dhe grimcave të tyre, dhe ndikimeve të tyre të kombinuara mbi njëra-tjetrën. Si rregull i përgjithshëm,

një Univers (të paktën si ai i yni) është një sistem i mbyllur, gjë që do të thotë se nuk mund të humbasë ose të fitojë një sasi të konsiderueshme energjie.

Në aspektin filozofik, një Univers mund të jetë një mori ligjesh bazike që rregullojnë sjelljen e gjithçkaje që vëzhgojmë. Një Univers do të përcaktohet nga rregullat e veta që përcaktojnë shpejtësinë e tij unike për dritën, që u tregojnë grimcave se si të shtyhen apo tërhiqen, apo hapësirës se si duhet të zgjerohet.

Çfarë është një Multivers në kozmologji?

Një shekull i vëzhgimeve astronomike na ka treguar shumë rreth moshës, madhësisë dhe evolucionit të galaktikave, yjeve, materies dhe 4 dimensioneve që i përmbledhim si hapësirë kohore. Diçka që e dimë më me shumë besim, është se gjithçka që shohim tani po zgjerohet me një shpejtësi të përsheptuar. Logjikisht, kjo nënkupton se Universi, ose të paktën ai në të cilin jetojmë, ishte dikur shumë më i vogël. Ne teorikisht mund ta shtrydhim të gjithë materien e Universit deri në një pikë ku përqendrimi i energjisë i

redukton atomet në një lëndë me grimca më të thjeshta dhe ku forcat bashkohen derisa të mos i dallojmë dot nga njëra-tjetra.

Nëse ecim sipas atij që njihet si një model ciklik i kozmologjisë, universi mëmë i parapriu në një farë mënyre universit tonë. Ose nëse bazohemi tek ai që njihet si një model ciklik konformal, universet zgjerohen për trilionat e trilionat vjet derisa grimcat e tyre të ftohta përhapen kaq shumë, saqë gjithçka duket dhe vepron si një univers krejtësisht i ri.

Nëse nuk ju pëlqejnë këto 2 modele, një teori tjetër supozon se universi ynë ka të ngjarë të jetë një vrimë e bardhë, pra fundi hipotetik i një vrime të zezë nga një tjetër univers.

Çfarë është një Multivers në fizikën kuantike?

Në fillimin e shekullit XX, fizikantët përpunuan disa teori që e përshkruanin materien si objekte të vogla që tregonin vetëm gjysmën e historisë. Gjysma tjetër ishte që materia sillej sikur të kishte tiparet e një vale.

Se çfarëdo të thotë kjo natyrë e dyfishtë e realitetit, kjo është ende një çështje debati, por nga

një perspektivë matematikore, ajo valë përshkruan ngritjen dhe rënien e një loje fati. Probabilitetet janë të integruara në vetë makinerinë që përbën ingranazhet e një Universi si i yni.

Në disertacionin e tij të doktoratës në vitin 1957, fizikanti amerikan Hjuks Everet sugjeroi se një varg mundësisht janë të gjitha po aq reale sa njëra-tjetra, duke përfaqësuar realitete aktuale – Universe të ndara – ashtu si aime të cilin jemi njohur që të gjithë.

Ajo që e bën të veçantë çdo univers në këtë interpretim të shumë botëve, është mënyra se si çdo valë ndërlihet me një matje specifike të marrë nga valët e tjera, një fenomen që ne e quajmë ndërthurje.

Çfarë është një Multivers në filozofi?

Një nga supozimet fillestare më themelore të shkencës, është se pavarësisht nga ato që të thotë nëna jote, ti nuk je i veçantë. Dhe asnjë njeri tjetër në planet, dhe për pasojë as Universi ynë. Ndërsa ngjarje të rralla ndodhin herë pas here, ne nuk u përgjigjemi dot Pyetjeve të Mëdha me termin “kështu ka ndodhur”.

Atëherë, përse Universi ynë duket sikur zotëron vetëm forcën e duhur të tërheqjes që lejon shfaqjen jo vetëm të grimcave, por edhe të bashkimit për periudha mjaft të gjata në atome, që mund t'i nënshtrohen kimisë komplekse për të prodhuar mendje të përpunuara si e jona? Duke folur në aspektin filozofik, parimi antropik sugjeron që ne mund ta kemi atë prapa.

A do të zbulojmë ndonjëherë Universe të tjerë?

Duke qenë se vetë përkufizimi i një Universi, mbështetet në një lloj rrethimi fizik duke mbajtur larg faktorët ndikues, është e vështirë të imagjinosh mënyra përmes të cilave mund të vëzhgojmë ekzistencën e një “motre apo “vëllai” për Universin tonë. Nëse do ta bënim, gjithsesi mund ta shohim atësi një zgjatim të Universit tonë.

Tani për tani, ne nuk kemi ende ndonjë arsye të fortë për të menduar se Universi ynë është gjithçka tjetër veçse jo unik. Duke qenë se jemi ende duke mësuar se si funksionon Universi ynë, boshllëqet aktuale në fizikë ende mund të mbyllën pa pasur ndonjë nevojë të imagjinojmë një realitet tjetër nga yni.

ScienceAlert – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Sot zhvillohet xhiroja e fundit në Superligë

Çështja e titullit për edicionin 2023/2024 ka përfunduar sikurse edhe klubeve që do të luajnë në garat evropiane dhe dy klubet që do të jenë pjesë e Ligës së Parë në sezonin e ri, e vetmja dilemë e pazgjidhur është se a do të luajnë në barazh Feronikeli 74 apo Gjilani



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 24 MAJ - Xhiroja e fundit e Superligës së Kosovës në futboll zhvillohet sot (e shtunë) nga ora 15:00. Çështja e titullit dhe skuadrave që do të marrin pjesë në ligat evropiane ka përfunduar, siç ka përfunduar edhe gara për dy skuadrat që edicionin e ardhshëm bëjnë gara në Ligën e Parë, derisa e hapur është vetëm gara për skuadrën që do të luajë në barazh.

Finalistët e Kupës, Prishtina dhe Ballkani, përballen sërish mes vete, por ndeshje pa ndonjë rëndësi të veçantë, pasi suharekasit tashmë e kanë siguruar titullin e kampionit e, në anën tjetër, kryeqytetasit kanë

humbur shpresën për pjesëmarrje në garat ndërkombëtare. Shpresën e vetme Prishtina për daljen në Evropë e kishte nëpërmjet Kupës, por aty është mposhtur pas penalltive nga kampioni Ballkani dhe në këtë mënyrë e mbyll një edicion aspak pozitiv. Llapi i shkon Lirisë dhe pret tri pikë për ta përfunduar edicionin në vendin e dytë, kurse prizrenasit sezonin tjetër do të bëjnë gara një rang më poshtë të futbollit. Skuadra e Dritës do ta pres Malishevën, derisa të dyja këto skuadra do të marrin pjesë në Evropë e që për malishevasit është një sukses i jashtëzakonshëm. Gjilani pret fitore ndaj Dukagjinit në Klinë në mënyrë që t'i shmanget barazhit, derisa në këtë pozitë është Feronikeli 74 që luan

ndaj Fushë-Kosovës. "Pampurat", sikurse Liria, sezonin tjetër do të jenë pjesë e Ligës së Parë.

SUPERLIGA	
Fushë Kosova - Feronikeli 74	
Drita - Malisheva	
Ballkani - Prishtina	
Liria - Llapi	
Dukagjini - Gjilani	
Tabela	
1. Ballkani	75 pikë
2. Llapi	68
3. Drita	66
4. Malisheva	56
5. Prishtina	49
6. Dukagjini	45
7. Gjilani	42
8. Feronikeli 74	41
9. Fushë Kosova	20
10. Liria	14

SHKURT

Zyba largohet nga Legia

Mesfushori Qëndrim Zyba nuk do të vazhdojë me Legian e Varshavës përtej këtij edicioni. Klubi polak në "Twitter" njoftoi se mesfushori kosovar do të largohet nga klubi. "Qëndrim Zyba do të largohet nga klubi", thuhet në njoftimin e klubit polak. Zyba fillimisht ishte raportuar se do të shitet te Legia, megjithatë në fund u vendos vetëm për një huazim deri në fund të sezonit nga Ballkani. Ai pati shumë pak minuta te Legia dhe nuk e fitoi besimin e klubit për të vazhduar. Zyba do të rikthehet te Ballkani dhe mbetet të shihet se a do ta vazhdojë karrierën diku tjetër.

KHF Istogu e fiton finalen e parë

Istogu e ka fituar ndeshjen e parë finale të plejofit në Superligën e Kosovës në hendboll. Hendbollistet istogase mposhtën Ferizajn me rezultat 31:27, duke bërë hapin e madh drejt mbrojtjes së titullit të kampionit. Ndeshja u zhvillua në palestrën "Bill Clinton" në Ferizaj. Ndeshja e dytë është në Banjë. Esmë Muratoviç ishte më efikasja tek Istogu me 8 gola. Gjashtë i kishte Arlinda Dinarica e nga pesë Carolina Ana Gomes e Silva Pat Batista. Aleksandra Bazoviç i kishte 11 pritje. Te Ferizaj më e dalluara ishte portierja Teninke Kaba me 14 pritje. Amanda Lemos i kishte dhjetë gola, ndërsa gjashtë Salematou Camara. Ferizaj e ka fituar Kupën, por tashmë është prapa në garën e fortë për titull.

Edvin Kuç largohet nga Ballkani, shkon te Neftchi Baku

Pas gjashtë viteve te Ballkani, Edvin Kuç ka vendosur t'i ndajë rrugët me kampionin e trefishtë të Kosovës në futboll. Një vendim të tillë Kuç e ka cilësuar tejet të vështirë. Duke folur për KosovaPress, Kuç ka deklaruar se po përballet me emocione të forta sepse ishin gjashtë vite të mrekullueshme në futbollin e Kosovës. Sa iu përket arsyeve të largimit, Kuç ka theksuar se vlerësoi se ishte koha e duhur për të ndryshuar ambient dhe për të provuar diçka të re, edhe për shkak të moshës që ka. Klubi i ri tashmë është zgjedhur nga reprezentuesi malazez. Kuç do të shkojë në Azerbajxhan tek Neftchi Baku. "Me shumë mundësi në Azerbajxhan, tek Neftchi Baku. Ata kishin shprehur interesim edhe në janar, tani me klubin vendosëm të qëndrojmë deri në verë sepse kishim pak mungesa të lojtarëve dhe tani ka përfunduar kontrata dhe shkoj atje si lojtar i lirë", ka deklaruar Kuç.

Andersen publikon listën e "dardaneve" për dy ndeshjet ndaj Kroacisë

PRISHTINË, 24 MAJ - Përzgjedhësja e Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Anneli Andersen, e ka publikuar listën e "dardaneve", të cilat janë përzgjedhur për dy ndeshjet e dyta të ciklit kualifikues për Kampionatin Evropian 2025. "Dardanet" ndeshjen e parë do ta zhvillojnë kundër Kroacisë në stadiumin "Zahir Pajaziti" në Podujevë më 31 maj. Ndeshjen e dytë

"dardanet" do ta zhvillojnë në stadiumin "Branko Cavlovic-Cavlek" në Karlovac, më 6 qershor, kundër Kroacisë. Përfaqësuesja e Kosovës në kualifikimet për Evropianin 2025 bën pjesë në Ligën B, në Grupin B4, së bashku me Uellsin, Kroacinë dhe Ukrainën. Në dy ndeshjet e para ka pësuar humbje ndaj Ukrainës dhe Uellsit. Lista e futbollisteve: Alma Demiri,

Florentina Kolgeci, Djellza Mehmeti, Edona Kyeziu, Rrezona Ramadani, Blerta Smaili, Albulena Fejza, Feride Kastrati, Fatlinda Ramaj, Viola Avdyli, Agnesa Gashi, Valentina Limani, Erleta Memeti, Blerta Shala, Besarta Hisenaj, Egzonë Zeka, Vanesa Hoti, Valentina Metaj, Marigonë Tahiri, Kaltrina Biqkaj, Modesta Uka, Elizabeta Ejupi, Lumbardha Misini, Loreta Lulaj.



Mbappe: Real Madrid? Më mirë pyesni mamanë time

MADRID, 24 MAJ - Kylian Mbappe do të nënshkruajë për Real Madridin kur kontrata e tij me Paris Saint-Germainin të skadojë në fund të muajit të ardhshëm. Megjithatë, francezi ende nuk ka konfirmuar asgjë edhe përkundër intervistave të fundit për media të ndryshme.

“Për momentin thashë se po largohem, por nuk po largohem menjëherë. Këto janë vetëm fjalë. Nuk kam bërë asnjë veprim në atë që do të bëj”, ka thënë Mbappe për RMC Sport, dhe ka shtuar: “Është e sigurt që kur të largohem nga Franca do të jetë diçka e vështirë sepse nuk do

ta gjej kurrë atë që kisha në Francë, gjëra të shkëlqyera. Për momentin po largohem nga PSG-ja. Kjo është e vetmja gjë që duhet ditur”. Duke i thënë se nëna e tij ka thënë se klubi i tij i ardhshëm është ‘i njohur’, Mbappe buzëqeshi dhe shtoi: “Nëse ajo e di, duhet të shkoni dhe ta pyesni”. Në fund,

Mbappe foli edhe për Lojërat Olimpike që do të mbahen këtë verë në Paris. “Nuk kam më nevojë të them se cilat janë qëllimet e mia. Të gjithë e dinë. Mendoj se duhet t’i lëmë gjërat të ndodhin, por Olimpiada është e veçantë, veçanërisht në Paris. Unë nuk di asgjë për të”, ka përfunduar Mbappe.



Barcelona shkarkon Xavin, pritet emërimi i Flickut

BARCELONË, 24 MAJ - Presidenti i Barcelonës, Joan Laporta, ka njoftuar pasditen e sotme se Xavi Hernandezi nuk do të vazhdojë të jetë trajner i ekipit të parë në sezonin 2024/25. Barcelona nuk do të ketë Xavin në krye të ekipit sezonin e ardhshëm, pas pesë muajsh pasigurie për të ardhmen e tij. Një muaj pas ditës kur e ardhmja e Xavit u ratifikua për vitin e fundit të kontratës së tij, ata i kanë thënë atij se ai nuk është në planet e tyre për sezonin e ri. Faqja zyrtare e klubit katalunas ka njoftuar shkarkimin e Xavit. “Xavi Hernandez nuk do të jetë më trajner në fund të sezonit. Në një takim që u zhvillua në Ciutat Esportiva Joan Gamper, presidenti Joan Laporta informoi Xavi Hernandezin se ai nuk do të vazhdojë të jetë trajner i ekipit të parë në sezonin 2024-25”, thuhet në njoftim.

Në takimin e zhvilluar në Ciutat Esportiva Joan Gamper të pranishëm ishin nënkryetari sportiv Rafa Yuste dhe drejtori



sportiv Deco, si dhe ndihmësit e Xavit, Oscar Hernandez dhe Sergio Alegre. Xavi Hernandez do ta drejtojë ndeshjen e tij të fundit si trajner i ekipit të parë këtë të diel në Sevilla, ndërsa në ditët në vijim Barcelona do të informojë për strukturën e re të ekipit të parë. Hansi Flick te Barcelona është një marrëveshje e mbyllur. Pritet vetëm zyrtarizimi, por më parë duhet njoftuar ndërprerja e

marrëveshjes me Xavin. Largimi i tij pritet të bëhet publik vetëm pas ndeshjes së fundit në La Liga, kundër Sevilas. “Mundo Deportivo” ka zbuluar detaje nga marrëveshja e arritur në Londër, mes Flick dhe përfaqësuesve të Barcelonës. Flick do të firmosë një kontratë 1+1, e cila përfundon pikërisht në vitin kur Laportas i përfundon mandati i tij si president.

Bostoni fiton edhe ndeshjen e dytë finale ndaj Indianas

BOSTON, 24 MAJ - Boston Celticsi mposhti bindshëm Indiana Pacercin me rezultat 126:110 në ndeshjen e dytë të finaleve të Konferencës Lindore dhe kaloi në epërsi 2:0. Pas pjesës së parë, Celticsi kryesoi me gjashtë pikë, 57:51, të cilën e rriti më pas dhe e fitoi me rezultat 126:110 ndeshjen e zhvilluar “TD Garden”. Jaylen Brown i udhëhoqi ata drejt fitores me 40 pikë, pesë kërcime dhe dy asistime, ndërsa Jayson Tatum dhe Derrick White shtuan nga 23 pikë secili. Tatum shtoi gjashtë kërcime dhe pesë asistime, ndërsa White gjashtë asistime dhe katër kërcime. Jrue Holiday e përfundoi ndeshjen me 15 pikë, dhjetë asistime dhe tri kërcime, ndërsa Payton Pritchard shtoi 12 pikë, me nga dy kërcime dhe asistime secili.



Tek Indiana, Pascal Siakam ishte më i miri me 28 pikë, pesë kërcime dhe dy asistime, dhe Andrew Nembhard shtoi 16 pikë me pesë asistime dhe dy kërcime. Obi Toppin e mbylli ndeshjen me 11 pikë dhe tri kërcime, ndërsa Tyrese

Haliburton ishte dyshifror me dhjetë pikë, tetë asistime dhe katër kërcime. Tani seria kalon në Indiana, ku Pacersi do të përpiqet ta barazojë rezultatin në dy ndeshjet që do t’i luajë para tifozëve vendas.

SHKURT

Salah pritet të largohet nga ‘Anfied’, Liverpooli mendon për Chiesan

Jo vetëm trajneri Jurgen Klopp, nga Liverpool pritet të largohet edhe Momo Salah, me sulmuesin egjiptian që po joshet gjithnjë e më shumë nga ofertat marramendëse që i vijnë nga Arabia Saudite. Sipas medieve angleze, drejtuesit e Liverpoolit kërkojnë t’i paraprijnë një largimi të mundshëm të Salahut, për këtë arsye po ndjekin nga pranë Federico Chiesan madje, sipas “Team Talk”, përfaqësues të klubit të kuq ishin të pranishëm në finalen e Kupës së Italisë, ku ndoqën nga pranë sulmuesin italian. Ndërkohë, Juventus po punon prej kohësh për ta zgjatur bashkëpunimin me Chiesan. Guintoli i ka ofruar një kontratë të re deri më 2028 dhe 5 milionë euro në sezon. Nëse Chiesa nuk rinovon, me shumë mundësi, sulmuesi pritet të transferohet në Premierë Ligë.

Carlos Sainz zgjedh makinën e së ardhmes

Gjithçka duket se po shkon ashtu sikurse edhe pritej. Piloti spanjoll i Ferrarit, Carlos Sainz, ka vendosur të jetë një pilot i Audisë, kur kjo e fundit do të zbarkojë në vitin 2026 në Formula 1. Në mes ka një sezon tjetër për t’u përballur, viti 2025, ndoshta si pilot me një ekip më pak konkurrues se “kokëkuqja”. Spanjollit ka vendosur ta pranojë propozimin e Sauberit, një skuadër që do të kalojë në pronësi të Audisë nga viti 2026, kur hyjnë në fuqi rregullat e reja. Sipas “Corriere dello Sport”, marrëveshja është arritur në Imola. Sainz ka bërë vlerësimet e tij të nevojshme, veçanërisht në bazë të vendeve të lira të mbetura. Gjatë muajve të fundit ka pasur thashetheme të shumta se ai do ta kishte parë në Red Bull ose Mercedes, por asnjë nga këto nuk është realizuar. Paraqitjet pozitive në fillim të sezonit do të çonin në rinovimin e Sergio Perezit me Red Bullin, ndërsa makina gjermane po shënjestron Kimi Antonellin.

I përfshirë në baste sportive, Paqueta rrezikon dënim prej 10 vjetësh

Lucas Paqueta është akuzuar nga Federata Angleze (FA) se ka ndikuar në përcaktimin e rezultateve të ndeshjeve si i përfshirë në bastet sportive në katër raste. Në ndeshjet kundër Leicester Cityt më 2022 dhe kundër Aston Villas, Leeds United dhe Bournemouth më 2023, braziliani, sipas deklaratës së FA-së, e cila tashmë e ka zyrtarizuar këtë akuzë, “ka kërkuar ta përcaktojë rrjedhën e ndeshjeve, duke marrë kartonin e verdhë me qëllim të pahijshëm për të ndikuar në tregun e basteve, për të krijuar fitim për një ose më shumë persona. Lojtari ka afat deri më 3 qershor për t’iu përgjigjur këtyre akuzave, si dhe për ta kërkuar shtyrjen e këtij afati”, thuhet në mesazh, duke përfunduar me informacionin se “Federata nuk do të bëjë asnjë koment të mëtejshëm derisa çështja të mbyllet”. Nëse vërtetohen të gjitha akuzat ndaj brazilianit, ai mund të marrë një ndëshkim shembullor prej 10 vjetësh pezullim.

Pioli nuk do të jetë më trajner i Milanit

Nuk ka më dyshime, Stefano Pioli nuk do të jetë më trajner i Milanit. AC Milan dhe Stefano Pioli njoftojnë se nuk do të vazhdojnë së bashku sezonin e ardhshëm, duke synuar ta ndërpresin marrëdhënien profesionale që i ka

lidhur që prej tetorit 2019. Milanit falënderon me përzemësi Stefano Piolin dhe të gjithë stafin e tij, për drejtimin e ekipit në këto pesë vjet, për marrjen e një Scudeto që do të mbetet e paharrueshme dhe që e riktheu Milanin përgjithmonë në

garat më të rëndësishme evropiane. Stefano, me profesionalizmin dhe humanizmin e tij, ishte në gjendje ta përmirësonte skuadrën dhe mishëroi vlerat themelore të klubit që nga dita e parë. Stefano Pioli

falënderon Milanin për mundësinë për të qenë pjesë e historisë së këtij klubi të lavdishëm dhe shpreh mirënjohjen e thellë për pronarët, drejtuesit, ekipin, stafin dhe të gjithë personelin e Milanello dhe Casa Milan për

mbështetjen dhe profesionalizmin e madh. Trajneri u drejton një mendim të veçantë tifozëve të shumtë që kanë mbështetur Milanin vitet e fundit, duke demonstruar lidhje të pakushtëzuar.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment Spatial Planning and Infrastructure

Njoftim publik për konsultime në procedurën e fazës së I-rë
për Kushtet Ndërtimore

“Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar “Sharri”.

Në bazë të Nenit 12 paragrafi 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrative Nr.01/2019 për lëshimin e Kushteve Ndërtimore për projektet e kategorisë së III.

Në lidhje me kërkesën paraprake për kushtet ndërtimore për projektin **“Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar “Sharri”.**

Nr. prot: 2317/23 të datës 03.05.2023, zyrtari përgjegjës i nënshkruar më poshtë informon publikun për hapjen e procedurës së konsultimeve për projektin e propozuar dhe fton publikun të dorëzojnë komentet dhe pyetjet e tyre, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e këtij publikimi.

Komentet dhe pyetjet mund të dorëzohen në:

Posta rekomande:

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
 Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit
 Ndërtesa e Rilindjes
 Kati i 14, zyra nr.1417, 10000 Prishtinë

Projekti mund të shkarkohet nga linku I mëposhtëm:

<http://mmph-rks.org/>

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni:

Departamentin e Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit
 Telefon: + 381 38 200 32 222

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, “Plastika-Av” Sh.p.k Rahovec në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për fabrikën e prodhimit të plastikës në formë primare në Rahovec.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 15.07.2024 në ora 11:00 në hapësirën e shkollës SHFMU "Isa Boletini"- Rahovec, do të organizohet debat publik nga Kompania “Plastika-Av” Sh.p.k Rahovec në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943

Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë “Plastika-Av” Sh.p.k Rahovec për fabrikën e prodhimit të plastikës në formë primare në Rahovec.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- “Ylyrian Travel Agency” L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 812145599.

- Gëzim M. Berisha B.I shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 810948234.

- Ilimi Sadrija shpall të humbur Certifikatën Furrтари, Mbi Aftësimin Profesional të lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale të Republikës së Kosovës me nr. 653/2015.

- Serdar Morina shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu “ Abdyl Frasheri “ Prizren.

- Albrim Isakaj shpall te pavlefshme 4 dëftesat , certifikatën dhe diplomën Q.K. “11 Marsi” Prizren.

- Armand Xhemaj shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën Q.K”11 Marsi” Prizren.

- Fatlind Rexha nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.t. “Nexhmedin Nixha” Gjakovë.

- Driton Ahmetaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 të sh.m.l.t. “Nexhmedin Nixha” Gjakovë.

- Ardian Kryeziu nga Rogova KK Gjakovë shpall të pavlefshme diplomën e Gjinnazit “Asllan Berisha” Rogovë KK Gjakovë.

Florent Gashi nga Rogova KK Gjakovë shpall të pavlefshme diplomën e Gjinnazit “Asllan Berisha” Rogovë KK Gjakovë.

Saranda Koci nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. “Zekiria Rexha” Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesa e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

Thirrje për aplikim

DOMINANT SHPK – Perfaqesuar nga **Burbuqe Gashi**, NUI **810867955**, me adresë Rr. Fehmi Agani, Prishtine, po kërkon ofertues/kontraktor/kompani të interesuar dhe të kualifikuar që të dorëzojë ofertë/propozim për:

"Furnizim dhe pune: Fidane te rrushit, Sistem mbeshtetes me shtylla metalike speciale, pune dore per mbejllje te fidaneve dhe vendosjen e komplet sistemit mbeshtetes"

Nr. Prokurimit 01-2024.

Emri: **DOMINANT SHPK**

Të interesuarit për aplikim dosjen me specifika mund ta kërkojnë përmes e-mailit: buqe_ga@hotmail.com

Adresa: Rr. Fehmi Agani, Prishtine

Tel: +383 (0)44 191 200

Ofertat duhen dorëzuar më së largu **15 dite nga dita e publikimit ne gazete, ora 16:00**, në zyrat e kompanisë Rr. Fehmi Agani, Prishtine



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

